



Telekomi i Kosovës Sh.A.
Kosovo Telecom J.S.C.

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Nenit 20, paragrafit 3, të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, si dhe Nenit 5 dhe Nenit 6 të Kodit të Mirësjelljes së Punonjësve dhe Procedurat Disiplinore nr. 01-5799/19 dt. 23.10.2019, miraton këtë:

RREGULLORE PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESIT NË TELEKOMIN E KOSOVËS SH.A.

KREU I DISPOZITA E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregullore ka për qëllim të identifikojë dhe parandalojë konfliktin ndërmjet interesit publik dhe interesit privat të zyrtarëve në ushtrimin e detyrës publike në Telekomin e Kosovës Sh.A., si dhe garantimin e kryerjes së detyrave dhe vendimmarrjes së paanshme, transparente, dhe në favor të Telekomit të Kosovës Sh.A. dhe interesit publik.

Neni 2 Objekti

Objekt i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i rregullave, mjeteve, mënyrave dhe procedurave për identifikimin, deklarimin, raportimin, regjistrimin, trajtimin, zgjidhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik si dhe masave për shkeljen e kësaj Rregulloreje.

Neni 3 Përkufizimet

Termat e përdoruar në këtë Rregullore kanë këto përkufizime:

1. "Interes publik" – nënkupton performancën e drejtë dhe të paanshme të zyrtarëve në ushtrimin e funksionit publik.
2. "Interes privat" i personit zyrtar – nënkupton çfarëdo përfitimi pasuror ose jo-pasuror për personin zyrtar, apo personat e afërt të tij, që mund të ndikojë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare në Telekomin e Kosovës Sh.A.

-
3. "Zyrtar" – përfshin të gjithë të punësuarit në Telekomin e Kosovës, pavarësisht pozitive zyrtare që kanë.
 4. "Zyrtar i lartë" – sipas ligjit përkatës për deklarimin kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë.
 5. "Person i afërt me zyrtarin" – është bashkëshorti apo personi që bashkëjeton me zyrtarin, i afërmi në vijë të drejtë të gjakut pa kufizime, i afërmi në vijë të tërthortë deri në shkallën e katërt, adoptuesi, i adoptuari, kujdestari, personi nën kujdes, në gjini të krushqisë deri në shkallën e tretë si dhe çdo person fizik apo juridik i cili ka pasur ose ka një lidhje të përbashkët të interesit privat pasuror ose jo pasuror me zyrtarin.
 6. "Konflikti i Interesit" – nënkupton çdo konflikt që lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.
 7. "Përfitim i padrejtë" – çdo pasuri dhe përfitim i padrejtë material ose jomaterial.
 8. "Dhuratë" - përcaktohet sipas Ligjit përkatës për deklarimin, kontrollin dhe prejardhjen e pasurisë.
 9. "Autoriteti përgjegjës" – është udhëheqësi i drejtpërdrejtë i zyrtarëve sipas hierarkisë, institucioni apo personi përgjegjës për identifikimin dhe trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit.
 10. "Agjencia" - nënkupton Agjencinë Kundër Korrupsionit.
 11. "Vendimmarrje" – çasti i fundit i procesit vendimmarrës gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit apo kontratës si dhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes të cilat janë thelbësore dhe përcaktuese në të cilat pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i zyrtarit përcaktojnë përmbajtjen përfundimtare të aktit apo kontratës si dhe çdo veprim i zyrtarit në ushtrimin e funksionit publik.
 12. "Personi Përgjegjës" – Zyrtari Kontaktues me Agjencinë Kundër Korrupsionit për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit.

Neni 4

Parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit

1. Zyrtari ushtron funksionin e tij në pajtim me Ligjet në fuqi, Kodin e Mirësjelljes së punonjësve dhe procedurat disiplinore në TK si dhe rregulloren e brendshme për parandalim të konfliktit të interesit në TK.
2. Zyrtari gjatë ushtrimit të detyrave publike duhet të veprojë në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që çfarëdo interesi privat ta vërë para interesit publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar.
3. Zyrtari duhet ta kryejë punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje dhe paanshmëri. Të ruajë autoritetin e zyrtarit dhe të institucionit dhe me punën e tij të rritë besimin e qytetarëve në institucion.
4. Zyrtari përgjigjet personalisht për veprimet e tij gjatë ushtrimit të detyrave për të cilat është emëruar apo zgjedhur nga institucioni.
5. Zyrtari nuk ka të drejtë të shfrytëzojë pozitën e tij për përfitim të kundërligjshëm për vete apo për të tjerët.

-
6. Zyrtari nuk mund të përdorë pozitën apo funksionin e tij për t'i avancuar interesat e veta personale apo të personave të afërt.
 7. Zyrtari gjatë ushtrimit të detyrave publike nuk ka të drejtë të krijojë marrëdhënie varësie nga persona të tjerë që do të mund të ndikonin në paanshmërinë dhe shprehjen e vullnetit të lirë në vendimmarrje.
 8. Zyrtari për punën që kryen në ushtrimin e detyrave publike nuk ka të drejtë të pranojë apo të kërkojë shpërblim tjetër përveç kompensimit që i lejohet në bazë të dispozitave ligjore në fuqi.

KREU II

KONFLIKTI I INTERESIT

Neni 5

Konflikti i interesit

"Konflikti i interesit" lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare.

Neni 6

Identifikimi i konfliktit të interesit dhe burimi i informatave

1. Çdo zyrtar i TK-së, apo çdo person tjetër, që ka njohuri ose dyshon për ndonjë konflikt interesi të ndonjë zyrtari, duhet të lajmërojë Personin Përgjegjës të TK-së, ose Agjencinë kundër Korrupsionit.
2. Palët e prekura nga veprimet e zyrtarit duhet të ofrojnë informata, bazuar në dyshimet e arsyeshme, të cilat i kanë në dispozicion në lidhje me rastin dhe të njëjtët gëzojnë mbrojtje në pajtim me ligjin.

Neni 7

Detyrimi i zyrtarit për Parandalimin dhe Zgjidhjen e Konfliktit të interesit

1. Zyrtari i TK-së, ka për detyrë të parandalojë në mënyrën më efektive të mundshme, çdo situatë të konfliktit të interesit që në momentin e shfaqjes.
2. Në rast se zyrtari është në dijeni apo ka dyshime për ekzistimin e konfliktit të interesit të lidhur me të, ai duhet të këshillohet sa më parë me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, apo personin përgjegjës.
3. Çdo udhëheqës, bashkë me personin përgjegjës duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur të gjitha rastet e konfliktit të interesit për vartësit e tyre.
4. Me rastin e marrjes së vendimeve që kanë të bëjnë me përbërjen e komisioneve për proceset tenderuese, apo komisioneve të tjera, drejtuesi i institucionit ose i autorizuari i tij duhet të marrin parasysh rrethanat e mundshme të konfliktit të interesit dhe t'i shmangin ato para marrjes së vendimit.

-
5. Në cilindo rast të identifikimit të konfliktit të interesit duhet të njoftohet personi përgjegjës apo Agjencia.

Neni 8

Veprimet e ndaluara për Zyrtarët e Telekomit të Kosovës

1. Zyrtarit të TK-së, gjatë ushtrimit të detyrës, i ndalohen këto veprime:
 - 1.1. të kërkojë, pranojë apo të përvetësojë dhuratë apo përfitim tjetër të padrejtë për vete apo personin tjetër, ose ofertë apo premtim për dhuratë, në mënyrë që zyrtari të veprojë ose të mos veprojë në kryerjen e detyrës së tij publike dhe në përcaktimin e tij në vendimmarrje;
 - 1.2. të ndikojë në kontraktimin, dhënien e punëve apo furnizimeve publike për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik;
 - 1.3. të shfrytëzojë informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit;
 - 1.4. të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten interesit personal të tij apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkaksionarëve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit;
 - 1.5. të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dëm të kompanisë;
 - 1.6. të fitojë për vete, personat e afërm dhe të besuar çdo përfitim të padrejtë ekzistues ose të ardhshëm, dhuratë, pjesë në kapital, aksione dhe pasuri nga personat juridikë privatë që përfitojnë kontrata publike, privatizim të pronës publike, lehtësi nga detyrimet doganore ose tatimore ose që ushtrojnë veprimtari të cilat ndikojnë drejtpërdrejt ose tërthorazi në fitimin e këtyre të drejtave në dobi të tyre;
 - 1.7. të ndërmarrë veprime me efekte ndëshkuese apo të bëhet pengesë për fitimin e të drejtave të ligjshme të zyrtarëve apo subjekteve që ofrojnë informata për raste të konfliktit të interesit të zyrtarit, personave të lidhur me të ose personave të besuar për këtë shkak;
 - 1.8. të përdorë ose të lejojë që të përdoren pasuritë zyrtare të TK-së, duke përfshirë dokumentet zyrtare dhe asetet teknike, për ndonjë qëllim tjetër që nuk përputhet me ushtrimin e detyrës publike;
 - 1.9. të jap me qera pronën private të tij apo personit të afërm të tij për vendosjen e aseteve teknike të kompanisë, përjashtimisht rastet strategjike kur rrezikohet mbarëvajtja e biznesit dhe kur nuk ka zgjidhje tjera alternative formohet Komisioni vlerësues i pavarur dhe profesional.

Neni 9
Ushtrimi i punëve të tjera nga zyrtari

1. Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit, zyrtari i TK-së mund të ushtrojë punë pas orarit, nga lëmia e shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje të tjera dhe nëse këto veprimtari apo punë nuk e dëmtojnë imazhin dhe të hyrat financiare të TK-së;
2. Gjatë kohës së ushtrimit të funksionit, zyrtari i TK-së mund të realizojë fitime në bazë të të drejtave të autorit, patentave, pronësisë intelektuale dhe industriale dhe të drejtave të ngjashme, nëse nuk parashihet ndryshe me ligje të tjera.
3. Zyrtari i TK-së do të ushtrojë funksionin e tij në harmoni me ligjin për ndërmarrje publike dhe në harmoni me kodin e etikës për qeverisje korporatave.

Neni 10
Punët e ndaluara për zyrtarin e TK-së

1. Zyrtarit të TK-së i ndalohet të kryejë punë apo angazhime me punë sekondare:
 - 1.1. Në institucione, subjekte apo kompani konkurruese të cilat japin shërbime telekomunikuese të ngjajshme me TK-në.
 - 1.2. Punët e tilla mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të detyrës zyrtare dhe cenojnë respektimin e parimeve të konkurrencës së lirë.
 - 1.3. Angazhimet e tilla mund të dëmtojnë imazhin dhe reputacionin e TK-së, të vlerësuar nga menaxhmenti.
 - 1.4. Angazhimi ka të bëjë me zgjedhjen, emërimin apo caktimin në subjektet kontraktuale të TK-së.
 - 1.5. Kur zyrtari i TK-së mund të keqpërdorë informacione zyrtare për interesa private.
2. Zyrtari i Telekomit obligohet që për çdo angazhim apo punë dytësore të njoftojë autoritetin përgjegjës dhe zyrën e personelit.

Neni 11
Papajtueshmëria me ushtrimin e funksionit në TK

1. Zyrtari i lartë i TK-së nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës, që përmes ndikimit të tyre e dëmtojnë imazhin dhe gjendjen financiare të TK-së.
2. Zyrtari i TK-së nuk ka të drejtë të lidhë kontratë, të përfitojë mbështetje financiare apo ndonjë përfitim tjetër kontraktual nga TK-ja, me organizatën ku ai ka pronësi ose pjesë të pronësisë, apo nëse organizata drejtohet nga personi i afërm i tij.
3. Nëse zyrtari i lartë apo zyrtari i TK-së bie në kundërshtim me paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni, atëherë TK duhet të kërkojë nga organi kompetent anulimin e kontratës me ndërmarrjen dhe kthimin e çfarëdo përfitimi të padrejtë tek TK-ja.

Neni 12
Tentimi dhe ndikimi në vullnetin e zyrtarit të TK-së

1. Nëse ndaj zyrtarit të TK-së, gjatë dhe lidhur me ushtrimin e funksionit zyrtar, ushtrohet ndikim i drejtpërdrejtë apo i tërthortë, haptazi apo në mënyrë anonime, për të marrë vendim konkret, zyrtari i TK-së e njofton me shkrim udhëheqësin e drejtpërdrejt, Zyrtarin Përgjegjës për Sinjalizim dhe Agjencinë, e cila pas shqyrtimit do të vendosë nëse ekziston një bazë e arsyeshme që të lajmërohen organet e ndjekjes.
2. Në rast tentimi apo ushtrimi të ndikimit për ta ndryshuar vullnetin e tij, Zyrtari i TK-së duhet:
 - 2.1. të refuzojë ofertën;
 - 2.2. të përpiqet të identifikojë ofertuesin nëse oferta është anonime dhe shkaqet ose interesat e mundshme; nëse është fjala për dhuratë e cila për shkak të rrethanave nuk mund të kthehet, zyrtari i TK-së duhet menjëherë ta njoftojë me shkrim dhe ta dorëzojë dhuratën te udhëheqësi, mundësisht sa më shpejtë dhe jo më vonë se pesë (5) ditë;
 - 2.3. të tregojë dëshmitarët e ndodhisë, nëse kjo është e mundur.

KREU III
DEKLARIMI I INTERESAVE PRIVATE

Neni 13
Deklarimi rast për rast i interesave private të zyrtarit të TK-së

1. Çdo zyrtar i TK-së, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vetëdeklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat ose të personave të afërm me të, lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhet shkak për lindjen e një konflikti të interesit dhe të tërhiqet nga kjo vendimmarrje.
2. Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i TK-së, kur kjo kërkohet nga udhëheqësi ose nga institucioni udhëheqës apo mbikëqyrës. Deklarimi, si rregull, duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur por jo më vonë se tridhjetë (30) ditë nga data e kërkesës ose e konstatimit të konfliktit të interesit.
3. Vetëdeklarimi ose deklarimi me kërkesë si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i TK-së përfshihet në një vendimmarrje për ndonjë çështje të caktuar.
4. Për çdo rast të shfaqjes së një konflikti të interesit, rast për rast, institucioni punëdhënës regjistron: identitetin e zyrtarit, interesat private të tij, shkakun për një konflikt interesi dhe konfliktin apo papajtueshmërinë e konstatuar, palët e interesuara, burimin e informatave, si dhe vendimet e marra për parandalimin, trajtimin dhe zgjidhjen e tyre.
5. Deklaratat për interesat private dhe të gjitha dokumentet që i shoqërojnë konsiderohen dokumente zyrtare.

Neni 14

Kufizimet e zyrtarit të TK-së pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike

1. Zyrtari i TK-së nuk ka të drejtë të përfshihet në marrëdhënie kontraktuale, ose të përfaqësojë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet ndonjë personi të afërm me institucionin ku ka ushtruar funksion publik (TK) për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik.

KREU V MBIKËQYRJA

Neni 15

Masat për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit

1. Në ushtrimin e funksionit, zyrtari i TK-së, sipas rastit dhe rrethanave:
 - 1.1. merr masa për vetëpërfshirjen ose përjashtimin paraprak nga procesi i vendimmarrjes dhe diskutimit të çështjes në konflikt.
 - 1.2. jep dorëheqje nga detyrat dhe funksionet, që janë në konflikt me funksionin e tij publik.
2. Çdo udhëheqës i drejtpërdrejtë është i obliguar që të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar dhe zgjidhur çfarëdo rasti të konfliktit të interesit, duke bërë kufizimin e informatave të caktuara, rishikimin ose ndryshimin e detyrave dhe kompetencave të zyrtarit, transferimin e zyrtarit në ndonjë detyrë tjetër, shmangien e emërimit të zyrtarit në funksione në të cilat ekziston ose mund të lindë konflikti i interesit, revokimin ose anulimin e një akti të marrë në kushtet e konfliktit të interesit.
3. Autoriteti Përgjegjës njofton Agjencinë për masat e marra për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit, ose papajtueshmërinë sipas kësaj rregulloreje.

Neni 16

Autoritetet përgjegjëse

1. Autoritetet përgjegjëse për zbatimin e kësaj rregulloreje në TK janë:
 - 1.1. udhëheqësit e drejtpërdrejtë të zyrtarëve të TK-së, sipas hierarkisë,
 - 1.2. institucionet dhe autoritetet udhëheqëse, sipas ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.
2. Personi Përgjegjës, në rastin e konfliktit të interesit, mbledh dhe pranon informata për zyrtarin e TK-së, dhe burimet e mbledhura nga brenda dhe jashtë institucionit i ruan konform ligjit përkatës për mbrojtjen e informatorëve dhe çdo dispozite tjetër në fuqi.
3. Verifikon besueshmërinë e burimeve dhe informatave, njofton zyrtarin për informatat e siguruar dhe i jep mundësi të provojë të kundërtën, nëse kjo kërkohet nga zyrtari i TK-së.
4. Personi Përgjegjës i dërgon Agjencisë çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se

data 31 janar, një raport për rastet e konfliktit të interesit.

Neni 17

Procedurat administrative të TK-së për rastet e konfliktit të interesit

1. Në raste të dyshimit të arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit, TK Sh.A inicion menjëherë procedurën për vërtetimin e ekzistencës së konfliktit të interesit dhe pasojat e tij.
2. Procedura e inicimit fillon:
 - 2.1 Sipas detyrës zyrtare (Menaxhmenti),
 - 2.2 Me kërkesë të Personit Përgjegjës,
 - 2.3 Me kërkesë të udhëheqësit të drejtpërdrejt,
 - 2.4 Në bazë të lajmërimit të ndonjë punonjësi tjetër apo lajmërimit anonim.
3. Procedura inicohet pranë Komisionit Disiplinor të TK Sh.A dhe Agjencisë.
4. Mosdeklarimi apo fshehja e konfliktit të interesit nga punonjësit përbën shkelje serioze disiplinore.

Neni 18

Detyrimet për luftimin e konfliktit të interesit si rezultat i lidhjeve familjare

1. Zyrtarët e TK-së duhet të deklarojnë lidhjet e tyre familjare brenda Telekomit të Kosovës.
2. Zyrtarët në pozita menaxheriale dhe punonjësit e TK-së, të cilët konsiderohen si persona të afërm me zyrtarin, nuk u lejohet që të jenë në hierarkinë e drejtpërdrejtë të mbikëqyrjes, vlerësimit dhe raportimit.

Neni 19

Deklarimi i konfliktit të interesit dhe lidhjeve familjare

1. Të gjithë punonjësit e TK-së, pavarësisht pozitës, do të deklarohen në formë të shkruar (deklaratë), me kërkesë të Departamentit të BNJ-së lidhur me konfliktin e interesit dhe lidhjet familjare brenda kompanisë.
2. Refuzimi apo deklarimi i rrejshëm nga paragrafi 1. i këtij neni afekton si shkelje e rëndë disiplinore.

Neni 20

Shmangia e konfliktit të interesit në raporte familjare

1. Menaxhmenti i TK-së ndërmerr veprime ligjore për rregullimin e pozitave brenda strukturës organizative ndaj zyrtarëve në Menaxhment dhe punonjësve të cilët janë në raporte të hierarkisë së drejtpërdrejt të mbikëqyrjes, vlerësimit dhe raportimit.
2. Autoriteti Përgjegjës, raporton te Kryeshefi Ekzekutiv për gjendjen rreth konfliktit të

-
- interesit dhe nepotizmit, lidhur me lëvizjet apo ndryshimet në zinxhirin e hierarkisë direkte të mbikëqyrjes, vlerësimit dhe raportimit në kundërshtim me këtë Rregullore.
3. Kryeshefi Ekzekutiv, i raporton Bordit të Drejtorëve lidhur me zbatimin e kësaj rregulloreje.

KREU VII SANKSIONET

Neni 21 Sanksionet

1. Çdo shkelje e detyrimeve të përcaktuara në këtë rregullore, do të bazohet në kodin përkatës të mirësjelljes dhe procedurave disiplinore, si dhe në Ligjin përkatës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, e që nuk përbën vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës, paraqet kundërvajtje dhe dënohet me gjobë, sipas Ligjit përkatës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Neni 22 Përgjegjësitë e tjera ligjore dhe pasojat mbi aktet

1. Çdo shkelje e dispozitave të kësaj rregulloreje, do të konsiderohet edhe si shkelje disiplinore, pavarësisht përgjegjësiwe eventuale penale. Shkeljet disiplinore trajtohen në pajtim me politikën, rregulloret, procedurat e brendshme dhe statusin e zyrtarëve. Punëdhënësi në momentin e inicimit të procedurës disiplinore, sipas kësaj rregulloreje do ta njoftojë Agjencinë për inicimin dhe rezultatin e procedurave.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje nuk përjashtojnë përgjegjësinë disiplinore dhe penale të zyrtarit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 23 Ndryshimi dhe Plotësimi i Rregullores

Kjo Rregullore mund të ndryshohet dhe plotësohet në çdo kohë nga Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh.A., në përputhje me nevojat ligjore dhe organizative.

KREU VII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 24
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas aprovimit dhe nënshkrimit nga Bordi i Drejtorëve të Telekomit të Kosovës Sh.A.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve
z.Shpëtim Dobra

